UDHËZIM
Nr.4, datë 23.4.2010

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.15, DATË 24.7.2007 "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.325, datë 19.3.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë", Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i tretë dhe i katërt i nenit 8 shfuqizohen.

Neni 2

Paragrafi i tretë i pikës 2 të nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

"Ndërmarrja e transportit do të provojë, në bazë të një vlerësimi financiar vjetor të kryer nga ekspertë ose kontabilistë të miratuar, që, çdo vit, ka të paktën në dispozicion kapital:

a) 4 000 euro për mjetin e parë dhe 2 000 euro për çdo mjet shtesë, kur kryen transport ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;

b) 30 000 lekë për mjetin e parë dhe 15 000 lekë për çdo mjet shtesë, kur kryen transport të mallrave dhe të udhëtarëve brenda vendit.

c) 700 000 lekë për agjenci transporti ndërkombëtar të udhëtarëve.

Përjashtimisht paragrafit 1, autoriteti kompetent pranon që një ndërmarrje të provojë gjendjen e përshtatshme financiare të saj, me anë të një vërtetimit si një garanci bankare, ose një sigurimi nga një ose më shumë banka ose institucione financiare, përfshirë kompanitë e sigurimit, si një garanci në lidhje me shumën e përcaktuar në paragrafin 1.".

Neni 3

Pas nenit 8, shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 8 /1

1. Një ndërmarrje që përfshihet në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, duhet të caktojë të paktën një person, si drejtues veprimtarie, i cili plotëson kërkesat sipas shkronjave "a" dhe "c" të nenit 8 të udhëzimit, dhe i cili:

a) drejton efektivisht dhe vazhdimisht veprimtarinë e transportit të ndërmarrjes;

b) është punonjës në ndërmarrje si drejtues ose pronar, ose aksionar, ose administrator i saj, ose kur ndërmarrja është një person fizik, është vetë ky person; dhe

c) është rezident në Shqipëri.

2. Nëse një ndërmarrje transporti nuk plotëson kërkesën e kompetencës profesionale të vendosur në shkronjën "c" të nenit 8 të udhëzimit, autoriteti kompetent i lëshimit të licencës mund të

licencojë atë pa drejtues veprimtarie sipas pikës 1 të këtij neni, duke siguruar që:

a) ndërmarrja të caktojë një person, i cili plotëson kërkesat e vendosura në shkronjat “a” dhe “c” të nenit 8 të udhëzimit dhe të cilit i është dhënë e drejta nëpërmjet një kontrate për kryerjen e detyrimeve si drejtues veprimtarie në emër të ndërmarrjes;

b) kontrata e lidhur nga ndërmarrja me personin e përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, specifikon detyrimet për t’u kryer mbi baza efektive dhe të vazhdueshme nga ky person, dhe tregon përgjegjësitë e tij si drejtues veprimtarie. Detyrimet e specifikuara do të përfshijnë, në veçanti, ato që lidhen me menaxhimin e mirëmbajtjes së mjeteve, verifikimin e kontratave dhe dokumenteve të transportit, veprimet financiare bazë, caktimin e ngarkesave ose shërbimeve për drejtuesit dhe mjetet, dhe verifikimin e procedurave të sigurisë;

c) në aftësinë si drejtues veprimtarie, personi referuar shkronjës “a” të kësaj pike mund të menaxhojë aktivitetet e transportit deri në tri ndërmarrje të ndryshme me seli ose filial brenda të njëjtit rreth që kryejnë transport udhëtarësh ose mallrash brenda vendit ose ndërkombëtar, me kushtin që numri total i mjeteve të ndërmarrjeve që menaxhohen nga një drejtues veprimtarie nuk duhet të kalojë 36 mjete motorike ose mjete të kombinuara.

3. Një drejtues veprimtarie, i caktuar në përputhje me pikën 1, veç kësaj nuk mund të caktohet si drejtues veprimtarie në përputhje me pikën 2 të këtij neni, ose mund të caktohet vetëm në dy ndërmarrje (përfshirë atë sipas pikës 1) me seli ose filial brenda të njëjtit rreth, kur numri total i mjeteve në të dy ndërmarrjet nuk i kalon të 30 mjete motorike ose mjete të kombinuara.

4. Ndërmarrja e transportit do ta njoftojë autoritetin kompetent të lëshimit të licencës për drejtuesin e veprimtarisë së caktuar, si dhe për çdo ndryshim të tij.”.

Neni 4

Pika 3 e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kërkesa në lidhje me kompetencën profesionale, plotësohet kur drejtuesi i veprimtarisë është i pajisur me certifikatë përkatëse të kompetencës profesionale për transport të udhëtarëve dhe, ose mallrave, të lëshuar sipas udhëzimit të Ministrit nr.1, datë 28.1.2009.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi